



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE



BULETINI I PRONËSISË INDUSTRIALE (Patenta)

Nr. 33/2021

Tiranë më, 01 Nentor 2021

Kodet e përdorura në gazette.....	3
INID Codes used in gazette	
Kodet e shteteve.....	4
States codes	
Patenta të lëshuara.....	9
Granted Patents	

Kodet INID dhe minimumi i kërkuar për identifikimin e të dhënave bibliografike lidhur me:

Patentat.

- (11) Numri i patentës
- (21) Numri kombëtar i aplikimit
- (22) Data e depozitimit në Shqipëri
- (30) Prioriteti
- (54) Titulli i shpikjes
- (57) Pretendtimet
- (71) Emri dhe adresa e aplikuesit
- (72) Emri/ Adresa e Shpikësit
- (73) Emri dhe adresa dhe pronarit të patentës
- (96) Numri dhe data ndërkombëtare e aplikimit
- (97) Numri dhe data Nderkombëtare e publikimit

Kodet e shteteve

Afghanistan / Afganistani	AF
Albania / Shqipëria	AL
Algeria / Algjeria	DZ
Angola / Anguila	AI
Antigua and Barbuda / Antigua dhe Barbud	AG
Argentina / Argjentina	AR
Aruba / Aruba	AW
Australia / Australia	AU
Austria / Austria	AT
Bahamas / Bahamas	BS
Bahrain / Bahrein	BH
Bangladesh / Bangladeshi	BD
Barbados / Barbados	BB
Belarus / Bjellorusia	BY
Belgium / Belgjika	BE
Belize / Belice	BZ
Benin / Benin	BJ
Bermuda / Bermuda	BM
Bhutan / Bhutan	BT
Bolivia / Bolivia	BO
Bosnia Herzegovina / Bosnja Hercegovina	BA
Botswana / Botsvana	BW
Bouvet Islands / Ishujt Buver	BV
Brazil / Brazili	BR
Brunei Darussalam/Brunei Darusalem	BN
Bulgaria / Bullgaria	BG
Burkina Faso / Burkina Faso	BF
Burma / Burma	MM
Burundi / Burundi	BI
Cambodia / Kamboxhia	KH
Cameroon / Kameruni	CM
Canada / Kanada	CA
Cape Verde / Kepi i Gjellbër	CV
Cayman Islands / Ishujt Kaiman	KY
Central African Republic / Republika e Afrikës Qendrore	CF
Chad/ Cadi	TD
Chile / Kili	CL
China / Kina	CN
Colombia / Kolumbia	CO
Comoros / Komoros	KM
Congo / Kongo	CG
Cook Islands / Ishujt Kuk	
Costa Rica / Kosta Rika	CR
Cote d'Ivoire / Bregu I Fildishte	CI
Croatia / Kroacia	HR
Cuba / Kuba	CU
Cyprus / Qipro	CY
Czech Republic / Republika Çeke	CZ

Denmark / Danimarka	DK
Djibouti / Xhibuti	DJ
Dominika / Domenika	DM
Dominican Republic / Republika Domenikane	DO
Ecuador / Ekuadori	EC
Egypt / Egjipti	EG
El Salvador / El Salvadori	SV
Equatorial Guinea / Guinea Ekuatoriale	GQ
Erintrea / Erintrea	ER
Estonia / Estonia	EE
Ethiopia / Etiopia	ET
Falkland Islans / Ishujt Malvine	FK
Fiji / Fixhi	FJ
Findland / Findland	FI
France / Franca	FR
Gabon / Gaboni	GA
Gambia / Gambia	GM
Georgia / Gjeorgjia	GE
Germany / Gjermania	DE
Ghana / Gana	GH
Giblartar / Gjibraltari	GI
Greece / Greqia	GR
Grenada / Granada	GD
Guatemala / Guatemala	GT
Guinea / Guinea	GN
Guinea Bissau / Guinea Bisao	GW
Guyana / Guajana	GY
Haiti / Haiti	HT
Honduras / Hondurasi	HN
Hong Kong / Hong Kongu	HK
Hungary / Hungaria	HU
Iceland / Islanda	IS
India / India	IN
Indonezia / Indonezia	ID
Iran / Irani	IR
Iraq / Iraku	IQ
Ireland / Irlanda	IE
Israel / Israeli	IL
Italy / Italia	IT
Jamaica / Xhamaika	JM
Japan / Japonia	JP
Jordan / Jordania	JO
Kazakhstan / Kazakistani	KZ
Kenya / Kenia	KE
Kiribati / Kiribati	KI
Korea / Korea	KR
Kyrgyzstan / Kirgistan	KG
Kwait / Kuvaiti	KW
Laos / Laosi	LA
Latvia / Letonia	LV
Lebanon / Libani	LB

Lesotho / Lesoto	LS
Liberia / Liberia	LR
Macau / Makau	MO
Madagascar / Madagaskari	MG
Malawi / Malavi	MW
Malaysia / Malaizia	MY
Maldives / Maldives	MV
Mali / Mali	ML
Malta / Malta	MT
Marshall Islands / Ishujt Marshall	MH
Mauritania / Mauritania	MR
Mauritius / Mauritius	MU
Mexico / Meksika	MX
Monaco / Monako	MC
Mongalia / Mongolia	MN
Montserrat / Montserrati	MS
Morocco / Maroku	MA
Mozambique / Mozambiku	MZ
Myanmar / Myanmar	MM
Namibia / Namibia	NA
Nauru / Nauru	NR
Nepal / Nepal	NP
Netherlands / Hollanda	NL
Netherlands Andilles /Antilet Hollandeze	AN
New Zealand / Zelanda e Re	NZ
Nicaragua / Nikaragua	NI
Niger / Nigeri	NE
Nigeria / Nigeria	NG
Norway / Norvegjia	NO
Oman / Omani	OM
Pakistan / Pakistani	PK
Palau / Palau	PW
Panama / Panamaja	PA
Papua New Guinea / Papua Guinea e Re	PG
Paraguay / Paraguai	PY
Peru / Peruja	PE
Philippines / Filipine	PH
Poland / Polonia	PL
Portugal / Portugalia	PT
Qatar / Katari	QA
Republik Of Moldova / Republika e Moldavise	MD
Romania / Rumania	RO
Russian Federation/Federata Ruse	RU
Rwanda / Ruanda	RW
Saint Helena / Shen Helena	SH
Saint Kitts and Nevis / Shen Kits dhe Nevis	KN
Saint Lucia / Shen Lucia	LC
Saint Vincent and the Grenadines / Shen Vinsenti dhe Grenadinet	VC
Samoa / Samoa	WS
San Marino / San Marino	SM
Sao Tome and Principe /Sao Tome dhe Principe	ST

Saudi Arabia / Arabia Saudite	SA
Senagal / Senegali	SN
Seychelles / Sejshellet	SC
Sierra Leone / Sierra Leone	SL
Singapore / Singapori	SG
Slovakia / Sllovakia	SK
Slovenia / Sllovenia	SI
Solomon Islans / Ishujt Solomone	SB
Somalia / Somalia	SO
South Africa / Afrika e Jugut	ZA
Spain / Spanja	ES
Sri Lanka / Sri Lanka	LK
Sudan / Sudani	SD
Suriname / Surinami	SR
Swaziland / Shvacilandi	SZ
Sweden / Suedia	SE
Switzerland / Zvicra	CH
Syria / Siria	SY
Taiwan / Taivani	TW
Thailand / Tailanda	TH
Togo / Togo	TG
Tonga / Tonga	TO
Trinidad and Tobago / Trinidad dhe Tobako	TT
Tinisia / Tunizia	TN
Turkey / Turqia	TR
Turkmenistan / Turkmenistani	TM
Turks and Caicis Islands / Ishujt Turk dhe Kaiko	TC
Tuvalu / Tuvalu	TV
Uganda / Uganda	UG
Ukraine / Ukraina	UA
United Arab Emirates /Emiratet e Bashkuara Arabe	AE
United Kingdom/ Mbreteria e Bashkuar	GB
United Republic of Tanzania / Republika e Bashkuar e Tanzanise	TZ
United States of America / Shtetet e Bashkuara te Amerikes	US
Uruguay / Uruguai	UY
Uzbekistan / Uzbekistani	UZ
Vanuatu / Vanuatu	VU
Vatican / Vatikani	VA
Venezuela / Venezuela	VE
Vietnam / Vietnami	VN
Virgin Islands / Ishujt Virxhin	VG
Yemen / Jemeni	YE
Yugoslavia / Jugosllavia	YU
Zaire / Zaireja	ZR
Zambia / Zambia	ZM
Zimbabwe / Zimbabve	ZW

PATENTA TË LËSHUARA

(11) **10402**

(97) EP3105246 / 31/03/2021

(96) 15717097.8 / 10/02/2015

(22) 09/06/2021

(21) AL/P/ 2021/435

(54) **FRENIM I SYNUAR I TGF BETA**

26/10/2021

(30) 201461938048 P 10/02/2014 US

(71) Merck Patent GmbH

Frankfurter Strasse 250, 64293 Darmstadt, DE

(72) LO, Kin-Ming (6 Carol Lane, Lexington, Massachusetts 02420)

(74) Raimonda KARAPICI

Rr. Ndreko Rino, Nd. 1, H. 34/Ap 28 Tiranë

(57)

1. Nje proteine e perbere nga:

nje polipeptide e pare e perbere nga

a) TGFβRII human, ose nje fragment i til i afte per lidhjen e TGFβ; dhe

b) te pakten nje zone variabel te zinxhirit te rende te nje antitrupi ose fragment lidhes-antigen i tij qe lidh proteinën njerëzore Ligand 1 i Programuar i Vdekjes (PD-L1); dhe

nje polipeptide e dyte e perbere nga te pakten nje zone variabel te zinxhirit te lehte te nje antitrupi ose fragment lidhes-antigen i tij qe lidh proteinën njerëzore PD-L1,

ku polipeptideja e pare perbehet nga vargu amino acid i Vargut ID NR:3,

ku polipeptideja e dyte perbehet nga vargu amino acid i Vargut ID NR: 1, dhe

ku zinxhiri i rende i polipeptides se pare dhe zinxhiri i lehte i polipeptides se dyte kur kombinohen, formojne nje vend lidhes antigen qe lidh PD-L1.

2. Proteina e pretendimit 1 qe permban dy polipeptide duke patur seicila prej tyre nje varg amino acid te Vargut ID NR: 3, dhe dy polipeptide duke patur seicila prej tyre nje varg amino acid qe konsiston ne vargun amino acid te Vargut ID NR: 1.

3. Nje acid nukleik te perbere nga nje varg nukleotide te pare qe kodon polipeptiden e pare sipas pretendimit 1 dhe nje varg nukleotide te dyte qe kodon polipeptiden e dyte sipas pretendimit 1.

4. Nje qelize e perbere nga acidi nukleik i pretendimit 3

5. Nje metode per prodhimin e nje proteine sipas pretendimit 1 qe perfshin a) TGFβRII, ose nje fragment te tij i afte te lidhe TGFβ, dhe b) nje antitруп, ose nje fragment antigen-lidhes te tij, qe lidh proteinën njerëzore Ligand 1 i Programuar i Vdekjes (PD-L1), metode qe konsiston ne mbajtjen e nje qelize sipas pretendimit 4 ne kondita qe lejojne shprehjen e proteines

6. Nje metode sipas pretendimit 5 qe perfshin me tej vjeljen e proteines.

7. Nje proteine sipas pretendimit 1 per perdorim ne terapi.

8. Nje perberje farmaceutike qe permban nje sasi efektive te nje proteine sipas pretendimit 1.

9. Nje proteine sipas pretendimit 1 per perdorim ne;

- (i) nje metode te frenimit te rritjes se tumorit tek nje pacient, metoda konsiston ne ekspozimin e tumorit ndaj proteine; ose.
- (ii) nje metode e trajtimit te kanserit tek nje pacient, metoda konsiston ne administrimin e proteine tek pacienti me kanser.

10. Nje proteine per perdorim sipas pretendimit 9, ku metoda perfshin me tej ekspozimin ndaj rrezatimit te pacientit me kanser dhe/ose administrimin e nje kimioterapeutiku.

11. Nje proteine per perdorim sipas pretendimit 9 ose pretendimit 10, ku tumori ose kanseri eshte zgjedhur nga grupi qe konsiston ne kolorektal, i gjirit, ovarian, pankreatik, gastrik, prostate, renal, cervical, mieloma, limfoma, leucemia, tiroide, endometrial, uterine, i flikezes se urines, neuroendokrine, kokes dhe qafes, melcise, nasofaringeal, testikular, kanser i qelizave te vogla te mushkerise, kanser i qelizave jo-te vogla te mushkerise, melanoma, kanseri i lekures ne qelizat bazale, kanseri i lekures me qeliza skuamoze, dermatofibrosarkoma protuberancat, carcinoma qelizore Merkel, glioblastoma, glioma, sarkoma, mesothelioma, dhe sindromat mielodisplastike.

12. Nje proteine sipas pretendimit 1, ku proteina bllokton nderveprimin ndermjet PD-L1 human dhe receptorit human PD-1.

(11) **10404**

(97) EP3500750 / 05/05/2021

(96) 17758835.7 / 18/08/2017

(22) 29/07/2021

(21) AL/P/ 2021/560

(54) **TURBINE ME ERE ME ROTOR VERTIKAL DHE KONSTRUKSION TE SIPERFAQES HYRESE;**

27/10/2021

(30) 202016104589 U 22/08/2016 DE

(71) VDX Germany GmbH

Bayreuther Str. 3, 42115 Wuppertal, DE

(72) WAGENKNECHT, Markus (Weberweg 2, 17498 Dersekow)

(74) Ditika HOXHA

Rr."Emin DURAKU" No.6/1, Ap.4-02, Tiranë

(57)

1. Impiant i energjisë me erë për gjenerimin e energjisë me anë të rrjedhjes incidentale të drejtpërdrejtë (2) duke pasur një stator (3) dhe të paktën një gjenerator i cili vihet në punë me anë të një rotorit vertikal (4), rotorit vertikal (4) i lidhur me statorin (3) i tillë që mund të rrotullohet rreth një boshti rotacional vertikal (X), të paktën tre fletë (helika) rotorit (7) të cilat fiksohen me anë të një aparati lidhës (6) të vendosur në rotorin vertikal (4), fletët e rotorit (7) të orientuara ne aparatit lidhës (6) për te pasur një drejtim rotacional identik (D), dhe statori (3) që ka një konstruksion të sipërfaqes së hyrjes (8) me të paktën katër faqe të brendshme (9) te cilat modelojn rotorin vertikal (4), fletët e rotorit (7) të konfiguruar ngjashem me krahë në prerje horizontale, dhe konstruksioni i sipërfaqes së hyrjes (8) që ka dy fletë statori te vendosura vertikalisht (12) të cilat qëndrojnë përballë njëra tjetrës dhe janë të ngjashëm me krahë në prerje horizontale, dhe dy fletë statori te vendosura horizontalisht (13) te cilat qëndrojnë përball njëra tjetrës, fletët e statorit (12, 13) të konfiguruar dhe vendosura në mënyrë të tillë që të akselerojnë një rrjedhë ajri e cila prodhohet me anë te rrjedhjes incidentale të drejtpërdrejtë (2) dhe rrjedh përmes konstruksionit të sipërfaqes së hyrjes (8) të statorit (3) të paktën në një zone në skaj (14) e cila shtrihet përgjat faqeve të brendshme (9) të fletëve të vendosura vertikalisht të statorit (12), zona ne skaj (14) ka

një gjerësi e cila shtrihet horizontalisht dhe pingul në lidhje me rrjedhjen incidentale të drejtpërdrejtë (2) dhe është më e vogël ose e barabartë me madhësinë e një seksioni të fletëve të statorit të vendosura vertikalish (12) i cili është më i gjërë horizontalisht dhe pingul në lidhje me rrjedhjen incidentale të drejtpërdrejtë (2), fletët e rotorit (7) të vendosura dhe konfiguruar në skajin e jashtëm të rotorit vertikal (4) në mënyrë të tillë që fletët e rotorit (7) të zhyten plotësisht në zonën përkatëse të skajit (14) të statorit (3) gjatë një rrotullimi të rotorit vertikal (4), karakterizuar nga fakti që fletët e statorit (12, 13) të konstruksionit të sipërfaqes së hyrjes (8) kanë në secilin rast, në një gjëndje bazë, një anë krahu (17) që shtrihet në mënyrë radiale nga ana e jashtme në lidhje me boshtin rrotullues (X) dhe faqja e brendshme (9) që shtrihet në mënyrë radiale nga ana e brendshme në lidhje me boshtin rrotullues (X) dhe është e konfiguruar si një anë krahu, faqet e brendshme (9) që shtrihet në mënyrë radiale nga ana e brendshme në lidhje me boshtin rrotullues (X) janë të fiksuara, dhe anët krah (17) të fletëve të statorit (12, 13), anët krah (17) në secilin rast shtrihet në mënyrë radiale nga ana e jashtme në lidhje me boshtin rrotullues (X), janë të lëvizshme (përkulshme/rrotullueshme) në një gjëndje të lëvizshme në secilin rast rreth skajit gjatësor të fletëve përkatëse të statorit (12, 13) në zonën e hyrjes së rrjedhjes incidentale të drejtpërdrejtë (2), në mënyrë që të formohet një gyp (18).

2. Impiant i energjisë me erë për gjenerimin e energjisë me ane të rrjedhjes incidentale të drejtpërdrejtë (2) sipas klauzolës karakterizuese të Pretendimit 1, **i karakterizuar nga fakti që** aparati lidhës (6) përfshin dy disqe rotor të shtrirë horizontalisht (6a), midis të cilave fletët e rotorit (7) janë montuar në një mënyrë të lëvizshme.
3. Impiant i energjisë me erë sipas pretendimeve 1 ose 2, **i karakterizuar nga fakti që** fletët e rotorit (7) lëvizin (rrotullohen) nga një pozicion fillestar në ndales të rotorit vertikal (4) në një pozicion maksimal përmes një boshti rrotullues (S) i cili është i montuar në aparatit lidhës (4) dhe është i vendosur vertikalisht, fletët e rotorit (7) marrin pozicionin e tyre maksimal në rastin që arrihet një shpejtësi e caktuar rrotullimi e rotorit vertikal (4), fletët e rotorit (7) lëvizin (rrotullohen) në drejtim të pozicionit maksimal ndërkohë që shpejtësia e rrotullimit rritet nën veprimin e forcave centrifugale.
4. Impiant i energjisë me erë sipas pretendimeve 1 deri në 3, **i karakterizuar nga fakti që** fletët e rotorit (7) kanë një majë flete përpara (71) e cila tregon në drejtimin e rrotullimit (X) dhe një majë flete të pasme (72) e cila tregon nga ana tjetër e drejtimin të rrotullimit (X), dhe nga fakti që fletët e rotorit (7) janë të montuara në rotorin vertikal (4) përmes aparatit lidhës (6) në cdo rast që të lëvizin në mënyrë të tillë që hapësira radiale e majës të pasme (72) të fletës përkatëse të rotorit (7) nga boshti rrotullues (X) rritet ndërsa rritet shpejtësia e rrotullimit.
5. Impiant i energjisë me erë sipas pretendimit 4, **i karakterizuar nga fakti që**, fletët e rotorit (7) janë të montuara në rotorin vertikal (4) përmes aparatit lidhës (6) në cdo rast që të lëvizin në mënyrë të tillë që hapësira radiale e majës përpara (71) të fletës përkatëse të rotorit (7) nga boshti rrotullues (X) zvogëlohet ndërsa rritet shpejtësia e rrotullimit.
6. Impiant i energjisë me erë sipas pretendimeve 1 deri në 5, **i karakterizuar nga fakti që**, nga një shpejtësi e erës së rrjedhjes incidentale të drejtpërdrejtë (2) prej më të madhe ose të barabartë me 3 m/s në më të madhe ose të barabartë me 5 m/s, fletët e rotorit (7) marrin një pozicion lëvizës në mënyrë të tillë që hapësira radiale e majës të pasme (72) të fletës përkatëse të rotorit (7) nga boshti rrotullues (X) rritet ndërsa rritet shpejtësia e rrotullimit.
7. Impiant i energjisë me erë sipas pretendimeve 1 deri në 6, **i karakterizuar nga fakti që**, nga një shpejtësi e erës së rrjedhjes incidentale të drejtpërdrejtë (2) prej më të vogël se ose të barabartë me 3 m/s në më të vogël ose barabartë me 5 m/s, fletët e rotorit (7) tërhiqen ose mbahen në pozicionin

fillestar me anë të mënyrave tërheqëse që kundërshtojnë forcën centrifugale që vepron mbi fletët e rotorit (7).

8. Impiant i energjisë me erë sipas pretendimit 7, **i karakterizuar nga fakti që**, të paktën një nga mënyrat e tërheqjes është një sustë.
9. Impiant i energjisë me erë sipas pretendimit 7 ose në 8, **i karakterizohuar nga fakti që**, të paktën një mënyrë tërheqjeje është vendosur në mënyrë të tillë që fletët e rotorit (7) të qëndrojnë në pozicionin e tyre maksimal deri në një rrotullim të plotë të rotorit vertikal (4) nga më pak se ose e barabartë me 60 deri në e më pak se ose e barabartë me 80 rrotullime në minutë.
10. Impiant i energjisë me erë sipas pretendimeve 1 deri në 9, **i karakterizuar nga fakti që** fletët e rotorit (7) kanë në çdo rast një prerje tërthore horizontale të fletës simetrike përgjat rrjedhjes incidentale të drejtpërdrejtë (2).
11. Impiant i energjisë me erë sipas pretendimeve 1 deri në 10, **i karakterizuar nga fakti që**, fletët e rotorit (7) kanë në çdo rast një prerje tërthore horizontale të fletës asimetrike përgjat rrjedhjes incidentale të drejtpërdrejtë (2) që është e tillë që një nga anët krah të fletëve të rotorit (7), ana e krahut shtrihet në mënyrë radiale nga ana e jashtme në lidhje me boshtin rrotullues (X), fryhet në një masë më të theksuar sesa një anë krah e fletëve të rotorit (7), e cila shtrihet në mënyrë radiale nga ana e brendshme.
12. Impiant i energjisë me erë sipas pretendimeve 1 deri në 11, **i karakterizuar nga fakti që**, gjatësia e fletëve të rotorit (7) nga maja e përparme e fletës (71) deri te maja e pasme (72) është në cdo rast të paktën $1/48$ dhe më së shumti $1/6$, mundësisht $1/12$ e perimetrit të përgjithshëm të rruges që përshkoi to (11).
13. Impiant i energjisë me erë sipas pretendimeve 1 deri në 12, **i karakterizuar nga fakti që**, boshtet rrotulluese (X) me të paktën 2 rotor vertikal (X) janë vendosur paralelisht me njëri tjetrin, që të paktën dy rotor vertikal (4) ndajnë një fletë statori vertikal (16) e cila ka një prerje tërthore horizontale të fletës simetrike përgjat rrjedhjes incidentale të drejtpërdrejtë (2).
14. Impiant i energjisë me erë sipas pretendimeve 1 deri në 13, **i karakterizuar nga fakti që**, boshtet rrotulluese (X) e të paktën 2 rotorëve vertikal (X) janë vendosur në mënyrë koaksiale me njëri tjetrin, që të paktën dy rotor vertikal (4) ndajnë një fletë statori vertikal e cila ka një prerje tërthore vertikale të fletës simetrike përgjat rrjedhjes incidentale të drejtpërdrejtë (2).
15. Impiant i energjisë me erë sipas pretendimeve 1 deri në 14, **i karakterizuar nga fakti që**, gjatësia në drejtim të rrjedhjes incidentale të drejtpërdrejtë (2) të fletës më të jashtme të statorit vertikal (12) dhe/ose të fletës më të jashtme të statorit horizontal (13), është në cdo rast më i madh se diametri i rruges së përshkruar (11) nga fletët përkatëse të rotorit (7).
16. Impiant i energjisë me erë sipas pretendimit 15, **i karakterizuar nga fakti që**, anët e krahut (17) të cilat shtrihen përballë njëra-tjetrës dhe shtrihet në mënyrë radiale nga ana e jashtme në lidhje me boshtin rrotullues (X), mbyllin një kënd (α) i cili është midis 90° dhe 125° në një gyp (18) në gjendje lëvizese.
17. Impiant i energjisë me erë sipas pretendimit 15 ose 16, **i karakterizuar nga fakti që**, anët e krahut (17) të cilat formojnë gypin (18) kanë panele diellore.

18. Impiant i energjisë me erë sipas pretendimit 17, **i karakterizuar nga fakti që**, anët e krahut (17) te cilat formojnë gypin (18) janë me konfigurim të rregullueshëm horizontal.
19. Impiant i energjisë me erë sipas pretendimeve 1 deri në 18, **i karakterizuar nga fakti që**, në rastin e një shpejtësie të erës së rrjedhjes incidentale të drejtpërdrejtë (2) e preferueshme ndërmjet 2.5 dhe 4 m/s, veçanërisht e preferueshme midis 3 dhe 3.5 m/s, anët e krahut (17) të cilat formojnë gypin lëvizin përsëri në gjendjen baze të fletëve të statorit (12, 13) të konstruksionit të sipërfaqes së hyrjes (8).
20. Impiant i energjisë me erë sipas pretendimeve 1 deri në 19, **i karakterizuar nga fakti që**, impiant i energjisë me erë (1) ka një mekanizëm ingranazhesh krim (spirale) të vendosur midis statorit (3) dhe një aparati fiksues, në mënyrë që impianti i energjisë me erë (1) të gjurmojë erën.
21. Impiant i energjisë me erë sipas pretendimeve 1 deri në 20, **i karakterizuar nga fakti që** fletët e statorit të vendosura horizontalisht (13) janë me konfigurim të njagjëm me krahët në prerjen tërthore vertikale.
22. Impiant i energjisë me erë sipas pretendimeve 1 deri në 21, **i karakterizuar nga fakti që**, faqet e fletëve të rotorit (7) janë konfiguruar të tilla që ato të mund të zgjaten ose shkurtohen mekanikisht.
23. Konstruksioni i faqes hyrëse të një statori të një impianti me erë (1) të ketë të pakten katër faqe të brendshme (9) dhe të paktën dy fletë statori të vendosura vertikalisht (12), te cilat qëndrojnë përballë njëra tjetrës dhe janë si aerofil në prerje tërthore horizontale, dhe të paktën dy fletë statori të vendosura horizontalisht (13) te cilat qëndrojnë përballë njëra tjetrës, fletët e statorit (12, 13) të konfiguruar dhe vendosura në mënyrë të tilla që të akselerojnë një rrjedhë ajri e cila prodhohet me anë të rrjedhjes incidentale të drejtpërdrejtë (2) dhe rrjedh përmes konstruksionit të sipërfaqes së hyrjes (8) të paktën në një zonë në skaj (14) e cila shtrihet përgjatë faqeve të brendshme (9) të fletëve të vendosura vertikalisht të statorit (12), i cili është më i gjërë horizontalisht dhe pingul me në lidhje me rrjedhën incidentale të drejtpërdrejtë (2), zona në skaj (14) ka një gjerësi e cila shtrihet horizontalisht dhe pingul në lidhje me rrjedhjen incidentale të drejtpërdrejtë (2) dhe është më e vogël ose e barabartë me madhësinë e një seksioni të fletëve të statorit të vendosura vertikalisht (12) i cili është më i gjërë horizontalisht dhe pingul në lidhje me rrjedhën incidentale të drejtpërdrejtë (2) karakterizohet nga fakti që, në një gjendje bazë, fletët e statorit (12, 13) në çdo rast kanë një anë aerofil (17) e cila shtrihet në mënyrë radiale nga ana e jashtme në lidhje me boshtin rrotullues (X) dhe faqja e brendshme (9) e cila është konfiguruar si një anë e aerofilit dhe shtrihet në mënyrë radiale nga ana e brendshme në lidhje me boshtin rrotullues (X), faqet e brendshme (9) që shtrihet në mënyrë radiale nga ana e brendshme në lidhje me boshtin rrotullues (X) janë të fiksuara, dhe ato anë aerofil (17) të fletëve të statorit (12, 13) te cilat në çdo rast që shtrihet në mënyrë radiale nga ana e jashtme në lidhje me boshtin rrotullues (X) janë të lëvizshme në një gjendje lëvizëse në çdo rast përgjatë skajit të fletëve përkatëse të statorit (12, 13) në zonën hyrëse të rrjedhjes incidentale frontale (2), në mënyrë që të formojnë një venturi (18).
24. Konstruksioni i faqes hyrëse sipas pretendimit 23, **i karakterizuar nga** tiparet e pjesëve karakterizuese të pakten njërit prej pretendimeve 16 deri në 19 ose 21.

(22) 13/08/2021

(21) AL/P/ 2021/602

(54) **PROTEINA BASHKIMI TATK-CDKL5, FORMULIME, KOMPOZIME, DHE PËRDORIMI I TYRE**

25/10/2021

(30) 201461946280 P 28/02/2014 US

(71) Alma Mater Studiorum - Università di Bologna

Via Zamboni, 33, Bologna, IT

(72) CIANI, Elisabetta (Via Bellacosta 40/2, 40126 Bologna) ;LACCONE, Franco (Carl Lutz Strasse 18, 2000 Stockerau)

(74) Krenar LOLOÇI

Rr. Ibrahim Rugova, P.1/1, Kati II, Tiranë, Shqipëri (Albania)

(57)

1. Një acid nukleik rekombinant që përfshin:

një sekuencë acidi nukleik CDKL5, ku sekuenca e acidit nukleik CDKL5 kodon një sekuencë polipeptide CDKL5, ku sekuenca polipeptide CDKL5 përfshin SEQ ID NO: 2 ose SEQ ID NO: 16; dhe

një sekuencë acidi nukleik TATκ, ku sekuenca e acidit nukleik TATκ kodon një sekuencë polipeptide TATκ, ku sekuenca polipeptide TATκ ka identitet sekuence 90% deri në 100% te SEQ ID NO: 4 dhe ku sekuenca e acidit nukleik TATκ është bashkuar në mënyrë operative me sekuencën e acidit nukleik CDKL5 dhe/ose sekuenca polipeptide TATκ është bashkuar në mënyrë operative me sekuencën polipeptide CDKL5.

2. Acidi nukleik rekombinant i pretendimit 1, ku acidi nukleik CDKL5 ka 90% deri 100% identitet sekuence te SEQ ID NO: 1 ose SEQ ID NO: 15.

3. Acidi nukleik rekombinant i pretendimit 1 ose 2, ku sekuenca e acidit nukleik TATκ ka 90% deri në 100% identitet sekuence te SEQ ID NO: 3.

4. Acidi nukleik rekombinant i çdonjërit prej pretendimeve 1-3, ku acidi nukleik rekombinant përfshin më tej një sekuencë acidi nukleik që kodon një proteinë target, ku sekuenca e acidit nukleik që kodon proteinën target është bashkuar në mënyrë operative me sekuencën e acidit nukleik CDKL5.

5. Acidi nukleik rekombinant i pretendimit 4, ku proteina target është zgjedhur nga grupi i përbërë prej: proteinës lidhëse të kitinit (CBP), proteinës lidhëse të maltozës (MBP), glutationës-S-transferazë (GST), poli(His), tioredoksina (TRX), poli(NANP), një FLAG-tag, V5-tag, Mic-tag, HA-tag, S-tag, SBP-Tag, Sftag 1, Softag 3, Tc tag, Xpress tag, Strep-tag, Isopeptag, Spi Tag, Ti tag, Proteinës Mbartëse Karboksil Biotinë (BCCP), dhe Nus tag.

6. Acidi nukleik rekombinant i çdonjërit prej pretendimeve 1-5, ku acidi nukleik rekombinant përfshin më tej një sekuencë acidi nukleik që kodon një proteinë raportuese, ku sekuenca e acidit nukleik që kodon proteinën raportuese është bashkuar në mënyrë operative me sekuencën e acidit nukleik CDKL5.
7. Acidi nukleik rekombinant i pretendimit 6, ku proteina raportuese është zgjedhur nga grupi i përbërë prej: një proteine fluoeshente, beta-galaktosidazë, një proteine luciferazë, një proteine rezistente ndaj antibiotikut, p-glukuronidazë, dhe fosfatazë alkaline.
8. Një vektor që përfshin acidin nukleik rekombinant të çdonjërit prej pretendimeve 1-7.
9. Vektori i pretendimit 8, ku vektori është i përshtatshëm për shprehje në një qelizë bakteriale.
10. Vektori i pretendimit 8, ku vektori është i përshtatshëm për shprehje në një qelizë gjitare.
11. Një metodë që përfshin qelizat transfektuese me acidin nukleik rekombinant të çdonjërit prej pretendimeve 1-7.
12. Metoda e pretendimit 11, ku acidi nukleik rekombinant përmbahet në një vektor.
13. Metoda e pretendimit 11 ose 12, ku qelizat përfshijnë qelizat bakteriale ose qelizat gjitare.

(11) **10394**

(97) EP3498725 / 09/06/2021

(96) 18203320.9 / 17/04/2014

(22) 13/08/2021

(21) AL/P/ 2021/603

(54) **STEROIDI 19-NOR C3,3-DIZËVENDËSUAR C21-N-PIRAZOLIL PËR PËRDORIM NË TERAPI**

25/10/2021

(30) PCT/CN2013/074323 17/04/2013 WO

(71) Sage Therapeutics, Inc.

215 First Street, Cambridge, MA 02142, US


(72) SALITURO, Francesco G. (25 Baker Drive, Marlborough, Massachusetts 01752); ROBICHAUD, Albert, Jean (3 Riverview Court, Ringoes, New Jersey 08551); HARRISON, Boyd, L. (9 Wheatston Court, Princeton Junction, New Jersey 08550); BOTELLA, Gabriel Martinez (17 Parmenter Road, Wayland, Massachusetts 01778) ;BERESIS, Richard Thomas (Apartment 2504, Building 1 199 Shimen 2 Road, Shanghai, 200040)

(74) Krenar LOLOÇI

Rr. Ibrahim Rugova, P.1/1, Kati II, Tiranë, Shqipëri (Albania)

(57)

1. Një përbërje e formulës




ose një kripë farmaceutikisht e pranueshme e saj,
për përdorim në trajtimin e një çrregullimi të humorit në një subjekt human.

2. Përbërja për përdorim siç pretendohet në pretendimin 1, ku çrregullimi i humorit është depresion.

3. Përbërja për përdorim siç pretendohet në pretendimet 1 ose 2, ku përbërja është për administrim oral, subkutan, intravenoz, ose intramuskular.

4. Përbërja për përdorim siç pretendohet në pretendimin 3, ku përbërja është për administrim oral.

5. Një përbërje e formulës




ose një kripë farmaceutikisht e pranueshme e saj,
për përdorim në lehtësimin ose parandalimin e PMS ose PND në një subjekt human.

6. Përbërja për përdorim siç pretendohet në pretendimin 5, ku përbërja është për administrim oral, subkutan, intravenoz, ose intramuskular.

7. Përbërja për përdorim siç pretendohet në pretendimin 6, ku përbërja është për administrim oral.

8. Një përbërje e formulës



ose një kripë farmaceutikisht e pranueshme e saj,

për përdorim në modulimin pozitiv ose negativ të një receptori GABA_A receptor në një subjekt human.

9. Përbërja për përdorim siç pretendohet në pretendimin 8, ku përbërja ndikon receptorin GABA_A në mënyrë pozitive.

10. Përbërja për përdorim siç pretendohet në pretendimet 8 ose 9, ku subjekti human ka një çrregullim të humorit.

11. Përbërja për përdorim siç pretendohet në pretendimin 10, ku çrregullimi i humorit është depresion.

12. Përbërja për përdorim siç pretendohet në ndonjërin prej pretendimeve 8 to 10, ku përbërja është për administrim oral, subkutan, intravenoz, ose intramuskular.

13. Përbërja për përdorim siç pretendohet në pretendimin 12, ku përbërja është për administrim oral.

(11) **10395**

(97) EP3538821 / 19/05/2021

(96) 16795316.5 / 11/11/2016

(22) 16/08/2021

(21) AL/P/ 2021/604

(54) **TJEGULL MODULARE**

25/10/2021

(30)

(71) Logic Swiss AG

Seestrasse 61, 6052 Hergiswil, CH

(72) SCHWERTNER, Heiko (Ottigenbühlstrasse 48, 6030 Ebikon) ;MAGGI, Romeo (Sonnhaldenstrasse 32, 6052 Hergiswil)

(74) Vladimir NIKA

Bul " Bajram CURRI", Pall.2, Shk.3, Ap.4, Tiranë

(57)

1. Një tjegull, mundësisht një tjegull çatie (1), për mbledhjen e energjisë nga burimet kinetike, termike dhe të dritës, që përfshin një kuti (2) me

- të paktën një qelizë fotovoltaike (3) për mbledhjen e energjisë nga një burim drite,

- të paktën një kolektor termik (4);

ku tjegulla përfshin të paktën një kanal ere (5) me një turbinë me erë (6).

2. Tjegull sipas pretendimit 1, **karakterizuar në atë që** kanali i erës (5) përfshin të paktën një hyrje (7) dhe të paktën një dalje (8), ku një zonë tërthore hyrëse dhe një zonë tërthore dalje janë më të mëdha se një zonë tërthore (9) e kanalit të erës (5) në mes hyrjes (7) dhe daljes (8).

3. Pllaka sipas pretendimit 1 ose 2, **karakterizuar në atë që** tjegulla përfshin një sipërfaqe konkave (10), ku sipërfaqja konkave (10) preferohet të jetë së paku pjesërisht e formuar nga

4. Tjegull sipas pretendimit 2 ose 3, **karakterizuar në atë që** kutia (2) përfshin një pllakë konkave (11) që kufizon kanalin e erës (5) dhe mundësisht siguron një bazë për të paktën një qelizë fotovoltaike (3).

5. Tjegull sipas njërit prej pretendimeve 3 dhe 4, **karakterizuar në atë që** tjegulla përfshin një fletë mbulesë transparente (15) që mbulon të paktën pjesërisht hapësirën e sipërfaqes konkave (10), ku fleta e mbulesës (15) preferohet të paktën të bëhet pjesërisht nga një material izolues zhurme, veçanërisht preferohet plastika.

6. Tjegull sipas njërit prej pretendimeve 1 deri në 5, **karakterizuar në atë që** të paktën një kolektor termik (4) vendoset midis së paku një qelize fotovoltaike (3) dhe të paktën një kanali ere (5) ose brenda të paktën një kanali ere (5).

7. Tjegull sipas njërit prej pretendimeve të mësipërme, **karakterizuar në atë që** tjegulla përfshin një shtresë gjeneratori termoelektrik (18) ngjitur me të paktën një qelizë fotovoltaike (3), mundësisht midis të paktën një qelize fotovoltaike (3) dhe një paretit, mundësisht pllaka konkave (11), e kanalit të erës (5).

8. Një shumicë tjegullash sipas njërës prej pretendimeve 1 deri në 7, **karakterizuar në atë që** tjegullat janë instaluar në një çati (101) ose mur (102) ose pus ose kullë ose sipërfaqe toke ose ujë ose vela ose sipërfaqe të cilat janë fleksibël ose sipërfaqe lëvizëse.
9. Një ndërtesë (100) që përfshin një shumicë tjegullash sipas njërës prej pretendimeve të mësipërme.

(11) **10396**

(97) EP3589543 / 26/05/2021

(96) 18712654.5 / 27/02/2018

(22) 17/08/2021

(21) AL/P/ 2021/605

(54) **AEROPLAN I PAJISUR ME NJË AGREGAT FLUTURIMI DYTËSOR**

25/10/2021

(30) 201700022745 01/03/2017 IT

(71) RPS Aerospace S.r.l.

Via Montegrappa 80, 25065 Lumezzane (BS), IT

(72) LUNERTI, Giacomo (Via Samoggia 21, 36100 Vicenza); VEZZOLI, Nausicaa Asia (Via San Bernardo 40, 20021 Bollate (MI)) ;BERNA, Andrea (Via San Filippo Neri 67, 25065 Lumezzane (BS))

(74) Fatos DEGA

Rr."Nikolla Tupe", N.2, H.4, A.30, Tiranë

(57)

1. Aeroplan i pilotuar në largësi (1) që përmban një njësi shtytëse kryesore (23) me të paktën një motor, një shumësi helikash (3) që vihen në rrotullim nga të paktën një prej motorëve në fjalë, dhe një njësi kontrolli kryesore që përfshin të paktën një marrës të konfiguruar për të marrë komanda nga një njësi kontrolli në largësi (telekomandë), ku aeroplani në fjalë (1) përfshin më tej një agregat fluturimi dytësor (4) të përshtatshëm për të ndërhyrë në rast dështimi (mosfunksionimi) të aeroplanit (1) ose emergjencës, ku ky agregat fluturimi dytësor (4) është i pajisur me një njësi kontrolli shtesë (5) të konfiguruar për përpunimin e të dhënave të rëndësishme të fluturimit, që përfshin një marrës shtesë (27) të konfiguruar për të marrë komanda nga një njësi tjetër telekomanduese (70), në rast dështimi ose emergjence, ku njësia e kontrollit shtesë (5) është e konfiguruar për të gjeneruar, si përgjigje, një komandë aktivizimi (S1) të përshtatshme për të aktivizuar një pajisje të parë (8) për nxjerrjen e krahut të sipërm (9) të vendosur në ndarjen e parë (12) të aeroplanit (1) dhe për të fryrë një krah të poshtëm (17) të vendosur në ndarjen e dytë (25) të aeroplanit (1), dhe gjithashtu për të gjeneruar një komandë ndalimi (S2) të njësies shtytëse kryesore (23), ku krah i sipërm (9) i lartpërmendur, është i manovrueshëm me anë të njësies tjetër telekomanduese (70), dhe krah i poshtëm (17) është formësuar për të bashkëpunuar me krahun e sipërm (9) për qëndrueshmërinë (stabilitetin) e aeroplanit.

2. Aeroplani (1) sipas pretendimit 1, ku njësia e kontrollit shtesë (5) e lartpërmendur pajiset me një shumësi sensorësh (6) për zbulimin e një vargu madhësish, ndër të cilat të paktën nxitimi linear dhe ai këndor, të cilëve iu nënshtrohet aeroplani (1) dhe presioni i mjedisit, ku njësia e kontrollit shtesë (5) e lartpërmendur konfigurohet për të krahasuar madhësitë e lartpërmendura me vlerat kufitare që identifikojnë një kusht dështimi të aeroplanit (1), për njohjen e këtij të fundit, dhe gjenerimin, në përgjigje, të komandës së lartpërmendur të aktivizimit (S1) dhe të ndalimit (S2).


3. Aeroplani (1) sipas pretendimit 1, ku njësia e kontrollit shtesë (5) e lartpërmendur konfigurohet për të monitoruar fuqinë e radio sinjalit që lidh aeroplanin (1) me njësinë tjetër telekomanduese (70) dhe për krahasimin e kësaj fuqie të radio sinjalit me vlerën kufitare që identifikon një kusht emergjence dhe gjenerimin, në përgjigje, të komandës së lartpërmendur të aktivizimit (S1) dhe të ndalimit (S2).

- 4.** Aeroplani (1) sipas pretendimit 1, ku njësia e kontrollit shtesë (5) e lartpërmendur konfigurohet për të njohur një komandë emergjence me anë të njësisë tjetër telekomanduese (70) të lartpërmendur, një gabim në sensorët e lartpërmendur (6) ose në shpjetësinë e aeroplanit që tejkalon një kufi sigurie të dhënë dhe gjenerimin, në përgjigje, të komandës së lartpërmendur të aktivizimit (S1) dhe të ndalimit (S2).
- 5.** Aeroplani (1) sipas pretendimit 1, ku pajisja e parë e lartpërmendur (8) përmban një dhomë zgjerimi (11) të palosur shakull brenda ndarjes së parë të lartpërmendur (12) të aeroplanit (1) dhe të lidhur me një rezervuar (10) brenda të cilit ruhet një fluid i ngjeshur me presion të lartë, ku rezervuari i lartpërmendur (10) pajiset me një valvul shkarkimi të shpejtë që në mënyrë të përshtatshme aktivizohet elektromekanikisht nga kontrolli i aktivizimit i lartpërmendur (S1) i gjeneruar nga njësia e kontrollit shtesë (5), në rast dështimi të aeroplanit (1) ose emergjence, ku kjo valvul konfigurohet për të çliruar fluidin e ngjeshur të lartpërmendur që përmbahet në rezervuarin (10) brenda dhomës së zgjerimit të lartpërmendur (11), ku dhoma e zgjerimit e lartpërmendur (11) është e përshtatshme për tu fryrë me shpejtësi për shkak të presionit të lartë që zbatohet brënda saj nga rezervuari (10), duke marrë formën e një koni ose cilindri për nxjerrjen dhe vendosjen e krahut të sipërm (9).
- 6.** Aeroplani (1) sipas pretendimit 1, ku krahu i sipërm i lartpërmendur (9) bëhet prej pëlhere ose materiali tjetër me veti elastike (fleksibilitet) dhe përbëhet kryesisht nga dy sipërfaqe në formë koni gjysmë të cunguar (14) që lidhen me njëra tjetrën, ku krahu i sipërm i lartpërmendur (9) lidhet te karkasa (2) e aeroplanit (1) me anën e një çifti kabllosh (15) të cilat nga ana e tyre ndahen në një shumësi kabllosh (16) të lidhura me krahun e sipërm (9) përgjatë perimetrit të tij, ku krahu i sipërm i lartpërmendur (9) çon gjithashtu te një kabëll drejtues (19) i përshtatshëm për të lidhur te mjetet e kontrollit të paktën një pikë të perimetrit të krahut të sipërm (9).
- 7.** Aeroplani (1) sipas pretendimit 6, ku krahu i sipërm i lartpërmendur (9) është i manovrueshëm prej mjeteve të kontrollit të lartpërmendura të lidhura me njësinë e kontrollit shtesë të lartpërmendur (5), ku mjetet e kontrollit të lartpërmendura janë të përshtatshme për tërheqjen e kabëllit drejtues të lartpërmendur (19) për të deformuar strukturën e krahut të sipërm (9) me anë të komandës në largësi të marrë nga njësia tjetër telekomanduese (70).
- 8.** Aeroplani (1) sipas pretendimit 5, ku krahu i poshtëm i fryrshëm i lartpërmendur (17) është në komunikim fluid me dhomën e zgjerimit të lartpërmendur (11) nëpërmjet një kanali dalës (18), ku krahu i poshtëm i lartpërmendur (17) fryhet prej fluidit të përdorur më parë për fryrjen e dhomës së zgjerimit (11).
- 9.** Aeroplani (1) sipas pretendimit 1, ku krahu i poshtëm i lartpërmendur (17) ka një lloj forme të standardizuar të profilit aerodinamik të përcaktuar nga organizata federale amerikane NACA.
- 10.** Aeroplani (1) sipas cilitdo prej pretendimeve paraprirëse, ku krahu i poshtëm i lartpërmendur (17) shërben si një airbag i përshtatshëm për mbrojtjen e pjesëve më dëmtuese të aeroplanit (1) nga goditjet me objektet ose njerëzit.
- 11.** Aeroplani (1) sipas pretendimit 6, ku krahu i sipërm i lartpërmendur (9) dhe krahu i poshtëm i lartpërmendur (17) formësohen për të gjeneruar një kthim të vijueshëm të aeroplanit (1), djathtas ose majtas, ndërsa nëpërmjet tërheqjes në largësi të kabëllit drejtues të lartpërmendur (19) është e mundur të gjenerohet një gjendje trajektoreje drejtvizore ose një gjendje kthese në drejtim të kundërt me atë të imponuar nga krahu i sipërm (9).
- 12.** Aeroplani (1) sipas cilitdo prej pretendimeve paraprirëse, ku agregati i fluturimit dytësor (4) përmban një shtytës propulsiv tjetër (20) të kontrolluar gjithashtu nga njësia telekomanduese (70) dhe që operon në një plan perpendikular me aksin e rrotullimit të aeroplanit (1), ku ky shtytës propulsiv tjetër (20) gjeneron

një rritje të forcës ngritëse.

Faqe 1

EP 3 589 543 B1



EP 3 589 543 B1




FIG.2

EP 3 589 543 B1




FIG.4

EP 3 589 543 B1




FIG.3

EP 3 589 543 B1




FIG.5

EP 3 589 543 B1




FIG.6

EP 3 589 543 B1




FIG.7

EP 3 589 543 B1




FIG.8

EP 3 589 543 B1




FIG.9




FIG.10

(11) **10420**

(97) EP3041864 / 21/07/2021

(96) 14759210.9 / 05/09/2014

(22) 17/08/2021

(21) AL/P/ 2021/606

(54) **PROTEINË LIDHËSE IL-18 (IL-18BP) NË SËMUNDJET INFLAMATORE**

29/10/2021

(30) 13183193 05/09/2013 EP

(71) AB2 Bio SA

EPFL Innovation Park Building B, 4th Floor, 1015 Lausanne, CH

(72) PFEIFER, Andrea (Route de Fenil 16A, CH-1806 St-Légier-La Chiésaz) ;DEL VAL, Greg (Rue du Nord 26, CH-1180 Rolle)

(74) Ela SHOMO PANIDHA

Euromarkpat Albania SH.P.K , Rr. A.Z. Çajupi, Pall. 20/4, Ap.15, Tiranë, 100

(57)

1. Një metodë e përcaktimit të sasisë së IL-18 të lirë në një mostër që përfshin që përfshin zbulimin e lidhjes specifike të proteinës lidhëse IL18 (IL-18BP) me proteinën IL-18 të lirë në mostër e cila përmban hapat e:

- a) prurjes së një mostre që dyshohet se përmban IL-18 të lirë në kontakt me IL-18BP, e cila në mënyrë specifike lidhet me IL-18 e lirë, por jo me IL-18 të lidhur në një kompleks dhe funksionon si molekulë kapëse për IL-18 e lirë;
- b) lejimit të IL-18BP të lidhet me IL-18 e lirë;
- c) zbulimit të lidhjes së IL-18 me IL-18BP duke përdorur një imuno-analizë për zbulim dhe përcaktim të sasisë së IL-18 të lirë në mostër duke përdorur një kurbë standarte lineare, e cila llogaritet për përqëndrimet e paracaktuara të IL-18 brenda intervalit prej 5 deri në 200 pg/mL.

2. Një metodë për identifikimin e një pacienti ose një popullate pacientësh që vuajnë nga një sëmundje ose çrregullim të lidhur me IL-18 të lirë në indet e trupit që përfshin:

përcaktimin e sasisë së IL-18 të lirë në një mostër duke përdorur metodën e pretendimit 1 për të identifikuar një subjekt që ka nivele jonormale të IL-18 të lirë dhe/ose ose një raport jonormal të IL-18/IL-18BP të lirë në mostrat e trupit, në mënyrë të veçantë në lëngjet e trupit, krahasuar me nivelet në lëngjet e trupit të një subjekti të kontrolluar të shëndetshëm, ku nivelet jonormale të sipërpërmendura të IL-18 të lirë në lëngjet e trupit:

- a) tejkalojnë nivelet në lëngjet e trupit të një subjekti të kontrolluar të shëndetshëm me 5%, 10%, 20%, 30%, 40%, 50%, 60%, 70%, 80%, 90%, 100%, ose më shumë se 100%; dhe
- b) janë ≥ 5 pg/mL dhe, në mënyrë të veçantë, deri në 10000 pg/mL, ndërsa sasia e IL-18 të lirë në serum të subjektit të shëndetshëm, në mënyrë të veçantë një njeri i shëndetshëm është ≤ 4 pg/mL.

3. Një proteinë lidhëse IL-18 (IL-18BP) për përdorim në trajtimin e një pacienti ose një popullatë pacientësh që është diagnostikuar se vuan nga një sëmundje ose çrregullim që lidhet me IL-18 e lirë në indet e trupit duke përdorur metodën e pretendimit 2, ku sëmundja ose çrregullimi i lidhur me IL-18 është

(a) një i zgjedhur nga grupi i përbërë prej sëmundjes pulmonare obstruktive kronike (COPD), dëmtimi i mushkërive i lidhur me transfuzion, displasia bronkopulmonare (BPD), sindroma e distresit akut respirator (ARDS), sëmundja e Adult Still, sëmundja e juvenile Still, sëmundja intersticiale e mushkërive (ILD), fibroza pulmonare idiopatike, fibroza cistike, hipertendioni arterial pulmonar, astma, bronhektazia, dështimi i zemrës, skleroza laterale amiotrofike (ALS), sëmundja e syve të thatë (DED), keratitis, ulçera dhe gërryerja e kornesë, neovaskularizimi i kornesë, neovaskularizimi patologjik intraokular, iritis, glaukoma, degjenerimi makular, sindroma e Sjögren, uveiti autoimun, sëmundja e Behçet, konjunktiviti, konjunktiviti alergjik, dermatitis i qepallës, diabet i tipit 2, sëmundja e mëlçisë yndyrore jo alkoolike (NAFLD), hepatiti steato, transplantimi hematologjik dhe i organeve të ngurta, dëmtimi i rehemit të ishemi, ethe Mesdhetare familiale, sindromat periodike të lidhura me receptorin 1 të faktorit të nekrozës tumoriale, sindromat e etheve periodike të lidhura me kriopirinën, sindromat hiper-IgD, përdhes, sindroma Schnitzler, granulomatoza e Wegener's gjithashtu e quajtur granulomatoza me poliangit (GPA), tiroidet e Hashimoto, sëmundja e Crohn, koliti ulçerativ; dhe/ose

(b) i shkaktuar nga infeksion viral; dhe/ose

(c) një manifestim sistematik i inflamacionit dhe sëmundjeve shoqëruese të shkaktuar nga IL-18 të zgjedhura nga grupi i përbërë prej emfizemës, infamacion i indeve, shkatërrim i indeve, heqje e mushkërive, zhdukje e enëve të gjakut, apoptozë e qelizave endoteliale, metaplazia mukoze, hipertrofi kardiake, zvogëlim i VEGF në indet e mushkërive, humbje e enëve pulmonare, muskulizimi i enëve, rimodelim i enëve të gjakut, depozitim i kolagjenit, shtresa ablastike elastine në mushkëri, rimodelim fibrotik i rrugëve të frymëmarrjes, zgjerim i hapësirës ajrore, rimodelimi kronik i rrugëve të frymëmarrjes dhe enëve pulmonare dhe ulja e funksionit pulmonar; dhe

ku trajtimi përfshin parandalimin, ndalimin, zbutjen ose kthimin e simptomave të lidhura me sëmundjen ose çrregullimin e sipërpërmendur.

4. Metoda e pretendimit 1 ose pretendimit 2, ose proteina lidhëse IL-18 për përdorim të pretendimit 3, ku IL-18BP është IL-18BP humane (hIL-18BP).

5. Metoda siç pretendohet në pretendimin 1, 2 ose 4, ose proteina lidhëse IL-18 për përdorimin e pretendimit 3 ose pretendimit 4, ku IL-18BP është një IL-18BP, e cila ka një identitet sekuece prej 80%,

85%, 90%, 91%, 92%, 93%, 94%, 95%, 96%, 97%, 98%, 99% ose 100% në sekuencën e përshkruar në SEQ ID NO: 7, ose një fragment funksional, i saj.

6. Proteina lidhëse IL-18 për përdorim të çdo njërit prej pretendimeve 3 deri në 5, ku subjekti për t'u trajtuar i përket një grupi të subjekteve të cilat janë përcaktuar të kenë nivele të ngritura të IL-18 të lirë dhe/ose një raport jonormal të IL-18/IL-18BP së lirë në mostrat e trupit në mënyrë të veçantë në lëngjet e trupit të zgjedhura nga grupi i përbërë prej lëngjeve të qarkullimit të lëngut të lavazhit bronko-alveolar (BALF), lëngjet e sekretimit, biopsia dhe indet e homogjenizuara, në mënyra të veçantë serum, plazma, urinë, lot, pështymë, lëngu biliar, djersë, nxjerrje, ekspirim, sputum, lëngu bronkoalveolar, sebum, qelizor, gjendër, mukozë, dhe sekretim i indeve krahasuar me nivelet e lëngjeve të trupit të një subjekti të shëndetshëm.

7. Një kuti diagnostikimi për zbulimin e IL-18 së lirë, që përfshin proteinën lidhëse IL-18 si molekulën kapëse, dhe një molekulë lidhëse specifike IL-18 e dytë si molekula e zbulimit, ku molekula e zbulimit është një antigjen, antitrop, ose reagent i dytë i etiketuar për zbulim, e cila lidhet me vende të ndryshme të IL-18 sesa molekula kapëse.

8. Kutia e diagnostikimit e pretendimit 7, ku proteina lidhëse IL-18 është IL-18BP humane (hIL-18BP).

9. Kutia e diagnostikimit e pretendimit 7 ose pretendimit 8, ku IL-18BP është IL-18BP, e cila ka një identitet sekuence prej 80%, 85%, 90%, 91%, 92%, 93%, 94%, 95%, 96%, 97%, 98%, 99% ose 100% në sekuencën e përshkruar në SEQ ID NO: 7, ose një fragment funksional i saj.

10. Kutia e diagnostikimit e çdo njërit prej pretendimeve 7-9 e cila mund të përdoret në një metodë sipas pretendimit 1 ose pretendimit 2.

(11) **10397**

(97) EP3551617 / 11/08/2021

(96) 17829372.6 / 05/12/2017

(22) 17/08/2021

